



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2460 / Prot  
2

Rrëshen, më 23 . 06 . 2026

**V E N D I M**

**Nr. 52 datë 22. 06. 2026**

**PËR**

**“MIRATIM E DOKUMENTIT TË PARË, TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMEËM (PBA) 2027 - 2029”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 68/2017, pika 3, neni 48, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" i ndryshuar, Udhëzimi nr. 7, datë 27.02.2026, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029", të kalendarit PBA 2027 - 2029 dhe buxhetit të vitit 2027, i miratuar me VKB. nr. 109 datë 29.12.2025, "Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027", Bashkia Mirditë, VKB nr. 21, datë 19.03.2026, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029", relacionin nr. 2460, datë 02.06.2026 dhe tabelat së bashku me projekt-vendimin paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 19.06.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Dokumentin e Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029, sipas relacionit nr. 2460 prot, datë 02.06.2026 dhe tabelave bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (GMS & të gjitha drejtoritë dhe angjensitë e Bashkisë Mirditë)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë!*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Aleksandër PICAËU**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

Nr. 2460 / Prot

Datë 02/06 / 2026

**P/V E N D I M**

Nr. 54 date 02.06.2026

**“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TE PARE, TE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029”**

Mbeshtetur në ligji nr. 139/2015" Për veteqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperisë” në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.23, date.30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetore afatmesëme” i ndryshuar, Udhëzimin e MF, nr.07, datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”, Në kalendarin e PBA 2027-2029 dhe buxhetit të vitit 2027, të miratuar me vkb nr. 109, datë.29.12.2025, në vkb nr.21, datë.19.03.2026 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetorë afatmesëm 2027-2029” Këshilli i Bashkisë pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i Bashkisë Mirditë ;

**V E N D O S I:**

- 1.Të miratoje dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 sipas dokumentave bashkëlidhur.
2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Gaspër TOPOLLAJ**

**Aleksander PICA KU**

**Paraqiten projektin**

Dr:zhvill ek tatim taksa:V.Gjoka

F.Fufi

P/zyres Juridike dhe prok: M.Topollaj

**KRYETARI**  
**Albert MËLYSHI**

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA MIRDITË**

**DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TATIM TAKSAVE**

Nr 2460 Prot

Datë 02/06 /2026

**RELACION**

**Mbi hartimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029.**

Per hartimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, jemi mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave numër 3, datë.28.02.2024 "Mbi përgatitjen e programit buxhetorë afatmesëm vendorë 2027-2029", i hartuar mbi bazën ligjore të nenit 4 dhe 24 të ligjiit nr.9936, datë.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetorë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.68, datë.27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", të ndryshuar, udhëzimin nr. 23, datë.30.07.2018 "Për procedurat standarte të të përgatitjes së programit buxhetorë afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar dhe udhëzimin nr 7, datë.27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027".

Gjithashtu edhe në vkb nr 109, datë.29.12.2025 "Për hartimin e kalendarit të programit buxhetorë afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027", dokument në të cilin përcaktohet afatet kohore dhe proceset e hapat qe ndiqen per hartimin deri ne finalizimin, në vkb nr.21, datë.19.03.2026 "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetorë afatmesëm 2027-2029". Si në tabelat e mëposhtme për 6 programe:

|                                                  | 2027           | 2028           | 2029           |
|--------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| <b>AA133 - Aparati dhe Drejtimi i Bashkisë</b>   |                |                |                |
| Shpenzime Personeli (600-601)                    | 124,788        | 125,091        | 123,795        |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 26,770         | 27,245         | 27,693         |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255)                | 3,022          | 5,200          | 5,200          |
| <b>Tavanet e Përgjithshme</b>                    | <b>154,579</b> | <b>157,536</b> | <b>156,688</b> |

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.a

| <b>AB133 - Punët Publike dhe Mirëmbajtja</b>               |                |                |                |
|------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Shpenzime Personeli (600-601)                              | 110,307        | 111,506        | 110,399        |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)           | 23,244         | 26,375         | 29,631         |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255)                          | 56,100         | 45,058         | 61,200         |
| <b>Tavanet e Përgjithshme</b>                              | <b>189,651</b> | <b>182,939</b> | <b>201,230</b> |
| <b>AC133 - Siguria Publike</b>                             |                |                |                |
| Shpenzime Personeli (600-601)                              | 64,726         | 64,750         | 64,750         |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)           | 7,525          | 8,035          | 8,295          |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255)                          | 0              | 5,000          | 3,000          |
| <b>Tavanet e Përgjithshme</b>                              | <b>72,250</b>  | <b>77,784</b>  | <b>76,045</b>  |
| <b>AD133 - Arsimi, Shërbimi Social, Kultura dhe Sporti</b> |                |                |                |
| Shpenzime Personeli (600-601)                              | 197,783        | 197,231        | 198,584        |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)           | 32,241         | 35,056         | 37,305         |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255)                          | 50             | 6,800          | 6,800          |
| <b>Tavanet e Përgjithshme</b>                              | <b>230,074</b> | <b>239,087</b> | <b>242,688</b> |

|                                                                  | <b>2027</b>    | <b>2028</b>    | <b>2029</b>    |
|------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| <b>AE133 - Bujqësia, Veterinaria dhe Pyjet</b>                   |                |                |                |
| Shpenzime Personeli (600-601)                                    | 48,562         | 48,707         | 49,059         |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)                 | 2,771          | 3,565          | 3,791          |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255)                                | 10,284         | 19,100         | 19,100         |
| <b>Tavanet e Përgjithshme</b>                                    | <b>61,616</b>  | <b>71,372</b>  | <b>71,950</b>  |
| <b>AI133 - Fondi Rezervë dhe Kontigjencë</b>                     |                |                |                |
| Shpenzime Personeli (600-601)                                    | 0              | 0              | 0              |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)                 | 4,000          | 4,000          | 4,000          |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255)                                | 0              | 0              | 0              |
| <b>Tavanet e Përgjithshme</b>                                    | <b>4,000</b>   | <b>4,000</b>   | <b>4,000</b>   |
| <b>Totali i Shpenzime Personeli (600-601)</b>                    | <b>546,165</b> | <b>547,285</b> | <b>546,586</b> |
| <b>Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)</b> | <b>96,550</b>  | <b>104,276</b> | <b>110,716</b> |
| <b>Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>                | <b>69,455</b>  | <b>81,158</b>  | <b>95,300</b>  |
| <b>Përgjithshme</b>                                              | <b>712,170</b> | <b>732,718</b> | <b>752,601</b> |

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.a

Dokumenti PBA 2027-2029 nga bashkia Mirdite është hartuar duke u mbështetur në shtojcën nr 5 ” te udhezimit nr.7, date.27.02.2026, **Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit 2027 për Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë**, nga e cila udhëzohej përdorimi tre kritereve:

- Informacionin për transfertat nga qeveria qendrore sipas shtojcës nr.1 të këtij udhëzimi.
- Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV).
- Metodologjinë e re të planifikimit dhe kodifikimit të programeve dhe produkteve, sipas kësaj shtojce.

Nën Metodologjinë e re, kodet e programit janë përcaktuar në një mënyrë krejtësisht të ndryshme. Dy shifrat e para të kodit të programit të NJVQV-së në Metodologjinë 2022 përbëhen nga shkronja, secila merr vlera nga A deri në Z. Tre shifrat e fundit përbëjnë kodin e entitetit të NJVQV-së.

Hartimi i dokumentit të PBA 27-29 është bërë në dy nivele:

-Buxhetim në nivel klasifikimi ekonomik niveli i llogarive 7 shifrore.

| KODI | EMËRTIMI I LLOGARISË                                    | PLANI<br>2027  | PLANI<br>2028  | PLANI<br>2029  |
|------|---------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
|      | <b>Shpenzime Personeli (600-601)</b>                    | <b>546,165</b> | <b>547,285</b> | <b>546,586</b> |
| 600  | Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli       | 473,129        | 471,639        | 470,940        |
| 601  | Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore      | 73,036         | 75,646         | 75,646         |
|      | <b>Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)</b> | <b>96,550</b>  | <b>104,276</b> | <b>110,716</b> |
| 602  | Mallra dhe sherbime te tjera                            | 87,130         | 92,256         | 99,187         |
| 603  | Subvencionet                                            | 0              | 250            | 0              |
| 604  | Transferime korrente te brendeshme                      | 1,500          | 2,000          | 2,000          |
| 605  | Transferimet korrente jashte                            | 0              | 0              | 0              |
| 606  | Transferta per buxhetet familiare dhe individet         | 3,920          | 5,770          | 5,528          |
| 609  | Rezervat                                                | 4,000          | 4,000          | 4,000          |
| 651  | Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme           | 0              | 0              | 0              |

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.a

|      |                                                                 |                |                |                |
|------|-----------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1661 | Te dala, huamarrje te tjera afatgjate                           | 0              | 0              | 0              |
|      | <b>Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>                        | <b>69,455</b>  | <b>81,158</b>  | <b>95,300</b>  |
| 230  | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara | 3,722          | 14,816         | 17,816         |
| 231  | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara   | 65,734         | 66,342         | 77,484         |
| 232  | Shpenzime transferimet kapitale                                 | 0              | 0              | 0              |
| 255  | Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme          | 0              | 0              | 0              |
|      | <b>TOTALI</b>                                                   | <b>712,170</b> | <b>732,718</b> | <b>752,601</b> |

Buxhetim në nivel programi ku Bashkia mirditë e ka hartuar dokumentin e projekt buxhetit afatmesëm në 6 programe

Nën Metodologjinë e re, kodet e programit janë përcaktuar në një mënyrë krejtësisht të ndryshme. Dy shifrat e para të kodit të programit të NJVQV-së në Metodologjinë 2022 përbëhen nga shkronja, secila merr vlera nga A deri në Z. Tre shifrat e fundit përbëjnë kodin e entitetit të NJVQV-së.

Ku përshkrimet e programeve janë bërë në deklaratën e politikës së programit për secilin program. Dhe konkretisht kemi të ilustruar një program si më poshtë (ku në këtë model janë bërë të gjitha programet e tjera).

**Programi: AA133 - Aparati dhe Drejtimi i Bashkisë**

|   |                                                                                |                                                                                                                                                |      |
|---|--------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| 1 | <b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>                                        | Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale, Ofrimi i shërbime të përgjithshme publike dhe efektiviteti i burimeve njerezore |      |
|   | <b>TP për Qëllimin:</b>                                                        | 2026                                                                                                                                           | 2030 |
|   | Koha mesatare e realizimit të pagesave (ditë) (dite)                           | 1                                                                                                                                              | 1    |
|   | % e borxhit tatimor (%)                                                        | 3                                                                                                                                              | 2    |
|   | Finalizimi i kontratave brenda afatit ligjor (%)                               | 100                                                                                                                                            | 100  |
|   | Raporti i personave të trajnuar kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë (%) | 80                                                                                                                                             | 100  |

|     |                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |      |      |      |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|------|------|
| 1.1 | Objektivi i Politikës së Programit                                             | Menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale. Ofrimi i shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit,shërbimet e juridike, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjete, zyrave të printimit dhe IT etj. Efektiviteti I menaxhimit te burimeve njerzore |      |      |      |
|     | TP për Objektivin:                                                             | 2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 2027 | 2028 | 2029 |
|     | Koha mesatare e realizimit te pagesave (ditë) (dite)                           | 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 1    | 1    | 1    |
|     | % e borxhit tatimor (%)                                                        | 3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 3    | 3    | 3    |
|     | Finalizimi I kontratave brenda afatit ligjor (%)                               | 100                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 100  | 100  | 100  |
|     |                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |      |      |      |
|     | Raporti i personave të trajnuar kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë (%) | 80                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 80   | 80   | 80   |
| 1.2 | Objektivi i Politikës së Programit                                             | Përmirësimi i menaxhimit dhe administrimit të Bashkisë nëpërmjet zbatimit të mandatit të saj me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, duke krijuar besim tek qytetarët nëpërmjet zbatimit të standarteve më të larta të profesionalizmit.                                                                                                                                                                                                                                                           |      |      |      |
|     | TP për Objektivin:                                                             | 2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 2027 | 2028 | 2029 |
|     | Koha mesatare e realizimit te pagesave (ditë) (dite)                           | 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 1    | 1    | 1    |
|     |                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |      |      |      |
|     | % e borxhit tatimor (%)                                                        | 3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 3    | 3    | 3    |
|     | Finalizimi I kontratave brenda afatit ligjor (%)                               | 100                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 100  | 100  | 100  |
|     | Raporti i personave të trajnuar kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë (%) | 80                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 80   | 80   | 80   |
| 2   | Qëllimi i Politikës së Programit                                               | Planifikimi dhe zhvillimi i banesave të përshtatshme në njësinë vendore. Veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |      |      |      |
|     | TP për Qëllimin:                                                               | 2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |      | 2030 |      |
|     | Koha mesatare per miratimin e lejeve (dite) (dite)                             | 60                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |      | 60   |      |
|     | Finalizimi I projekteve brenda afatit te percaktuar (%)                        | 100                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |      | 98   |      |
| 2.1 | Objektivi i Politikës së Programit                                             | Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistikes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |      |      |      |

ADRESA. SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

|     |                                                         |                                                                                                           |      |      |      |
|-----|---------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|------|------|
|     | <b>TP për Objektivin:</b>                               | 2026                                                                                                      | 2027 | 2028 | 2029 |
|     | Koha mesatare per miratimin e lejeve (dite)             | 60                                                                                                        | 60   | 60   | 60   |
|     | Finalizimi I projekteve brenda afatit te percaktuar (%) | 100                                                                                                       | 100  | 100  | 100  |
| 2.2 | <b>Objektivi i Politikës së Programit</b>               | Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social. |      |      |      |
|     | <b>TP për Objektivin:</b>                               | 2026                                                                                                      | 2027 | 2028 | 2029 |
|     | Nr i familjeve te strehuara (nr familjesh)              | 50                                                                                                        | 50   | 50   | 50   |

| KODI | EMËRTIMI I LLOGARISË                                            | PLANI 2027     | PLANI 2028     | PLANI 2029     |
|------|-----------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|
|      | <b>Shpenzime Personeli (600-601)</b>                            | <b>124,788</b> | <b>125,091</b> | <b>123,795</b> |
| 600  | Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli               | 107,698        | 107,698        | 106,402        |
| 601  | Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore              | 17,090         | 17,393         | 17,393         |
|      | <b>Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)</b>         | <b>26,770</b>  | <b>27,245</b>  | <b>27,693</b>  |
| 602  | Mallra dhe sherbime te tjera                                    | 26,070         | 26,545         | 26,793         |
| 603  | Subvencionet                                                    | 0              | 0              | 0              |
| 604  | Transferime korrente te brendeshme                              | 0              | 0              | 0              |
| 605  | Transferimet korrente jashte                                    | 0              | 0              | 0              |
| 606  | Transferta per buxhetet familiare dhe individet                 | 700            | 700            | 900            |
| 609  | Rezervat                                                        | 0              | 0              | 0              |
| 651  | Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme                   | 0              | 0              | 0              |
| 1661 | Te dala, huamarrje te tjera afatgjate                           | 0              | 0              | 0              |
|      | <b>Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>                        | <b>3,022</b>   | <b>5,200</b>   | <b>5,200</b>   |
| 230  | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara | 2,722          | 5,000          | 5,000          |
| 231  | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te truepuara    | 300            | 200            | 200            |
| 232  | Shpenzime transferimet kapitale                                 | 0              | 0              | 0              |
| 255  | Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme          | 0              | 0              | 0              |
|      | <b>TOTALI</b>                                                   | <b>154,579</b> | <b>157,536</b> | <b>156,688</b> |

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.a

Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit.

Përveç përshkrimit të programit në deklaratën e politikës së programit është bërë përshkrimi i qëllimit të politikës së programi( në disa qëllime nëse ka):

Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale, Ofrimi i shërbime të përgjithshme publike dhe efektiviteti i burimeve njerëzore  
Dhe përshkrimi i objektivave të politikës së programit(në disa objektiva nëse ka)

Menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale. Ofrimi i shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit,shërbimet e juridike, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj. Efektiviteti i menaxhimit të burimeve njerëzore

Gjithashtu theksojmë se në përgatitjen e PBA ka patur gjithë përfshirje të gjithë ekipeve të EMP-ve, duke plotësuar të gjitha shifrat në tabelat e e PBA-së

Përgatiti


Përgj.sekt/fin/buxhet

Flora Fufi



Dr.zhvill.ek.tatim.talsave

Vjollca Gjoka



MIRATOI  
KRYETARI  
Albert MËLYSHI



TABELA 7.1

## PERMBLEDHËSE

PBA 2027 - 2029

| Emertimi i shpenzimit                                                             | PLANI 2027           |                                           |            | PLANI 2028  |                                       |             | PLANI 2029  |                                       |             |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------|-------------------------------------------|------------|-------------|---------------------------------------|-------------|-------------|---------------------------------------|-------------|
|                                                                                   | Llogaritja Ekonomike | Transferite e Pakushtezuar e Pergjithshme | Te ardhura | TOTALI      | Transferite e Pakushtezuar Sektoriale | Te ardhura  | TOTALI      | Transferite e Pakushtezuar Sektoriale | Te ardhura  |
| Paga                                                                              | 600                  | 232,704,218                               | 57,514,810 | 473,128,847 | 238,381,117                           | 184,539,155 | 473,128,847 | 238,381,117                           | 184,539,155 |
| Signurme                                                                          | 601                  | 46,172,619                                | 26,356,560 | 73,036,191  | 47,009,731                            | 27,329,409  | 73,036,191  | 47,009,731                            | 27,329,409  |
| TOTALI (600+601)                                                                  |                      | 278,876,837                               | 58,021,822 | 546,165,038 | 286,490,848                           | 211,768,564 | 546,165,038 | 286,490,848                           | 211,768,564 |
| Shpenzime operative                                                               | 602-606              |                                           |            |             |                                       |             |             |                                       |             |
| Energji Elektrike                                                                 |                      | 2,050,000                                 | 1,844,813  | 10,000,000  | 3,050,000                             | 6,105,425   | 11,000,238  | 4,050,000                             | 1,844,813   |
| Uje                                                                               |                      | 788,600                                   | -          | 1,800,000   | 2,023,379                             | 544,021     | 2,567,600   | 1,923,579                             | 644,021     |
| Telekom (internet)                                                                |                      | 655,000                                   | -          | 920,000     | 653,000                               | -           | 920,000     | 900,000                               | 20,000      |
